



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E FINANCAVE DHE  
EKONOMISË

Nr. 12688 Prot. datë 10.7.2023



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E ARSIMIT DHE  
SPORTIT

Nr. 4439/1 Prot. datë 20.7.2023

URDHËR I PËRBASHKËT

Nr. 160, datë 10.7.2023

PËR  
MIRATIMIN E RREGULLORES SË KOMITETEVE SEKTORIALE

Në mbështetje të pikës 4 të nenit 102 të Kushtetutës, të pikës 8 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 426, datë 26.6.2019 "Për mënyrën e organizimit, të funksionimit, si dhe kriteret e përzgjedhjes së anëtarëve të komiteteve sektoriale dhe mënyrën e shpërblimit të tyre".

URDHËROJMË:

1. Miratimin e Rregullores së Komiteteve Sektoriale, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij urdhri dhe është pjesë përbërëse.
2. Ngarkohen Komitetet Sektoriale për zbatimin e këtij urdhri.
3. Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.



**RREGULLORE**  
**PËR FUNKSIONIMIN E KOMITETIT SEKTORIAL**

**Neni 1**  
**Objekti**

1. Kjo Rregullore ka për objekt përcaktimin e rregullave të funksionimit të Komiteteve Sektoriale, në vijim referuar si "Komiteti Sektorial".
2. Komiteti Sektorial është një organ kolegjal i institucionalizuar bashkëpunimi, i parashikuar nga legjislacioni për Kornizën Shqiptare të Kualifikimeve (KSHK) për të mbështetur Agjencinë Kombëtare të Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve (AKAFPK) në ushtrimin e funksioneve të KSHK.
3. Komiteti Sektorial synon të përforcojë bashkëpunimin mes sektorit përkatës që përfaqëson dhe sistemit të Arsimit dhe Formimit Profesional (AFP) për të nxitur pjesëmarrjen aktive të partnerëve socialë në hartimin e Katalogut Kombëtar të Kualifikimeve Profesionale dhe ka për qëllim të kontribuojë në plotësimin e hendekut mes ofertës dhe aftësive të kërkuara, si dhe në përfshirjen e kualifikimeve të reja, të nevojshme për sektorin përkatës.

**Neni 2**  
**Baza ligjore**

Rregullorja bazohet në:

- Ligjin nr. 10247, datë 04.03.2010 "Për Kornizën Shqiptare të Kualifikimeve", të ndryshuar;
- Ligjin nr. 8480, datë 27.05.1999 "Për funksionimin e organeve kolegjiiale të administratës shtetërore dhe enteve publike";
- Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 426, datë 26.06.2019 "Për mënyrën e organizimit, të funksionimit, si dhe kriteret e përzgjedhjes së anëtarëve të komiteteve sektoriale dhe mënyrën e shpërblimit të tyre";
- Vendimin e Këshillit të Ministrave nr.656, datë 31.10.2018 "Për përcaktimin e masës së shpërblimit të anëtarëve të Këshillave, Bordeve ose Komisioneve të Përhershme të njësive të qeverisjes qendrore", të ndryshuar.

**Neni 3**  
**Parimet e funksionimit të Komitetit Sektorial**

1. Komiteti Sektorial ushtron funksionet e tij nëpërmjet angazhimit të përkushtuar të anëtarëve dhe organizatave që ata përfaqësojnë në përmbushje të interesit publik.
2. Anëtarët e Komitetit Sektorial kryejnë veprimtarinë e tyre në përputhje me:
  - a) parimin e ligjshmërisë;
  - b) parimin e përgjegjshmërisë dhe objektivitetit;
  - c) parimin e transparencës;

d) parimin e mbrojtjes së të dhënave dhe konfidencialitetit.

#### **Neni 4**

##### **Konflikti i interesit**

1. Anëtarët e Komitetit Sektorial mund të ndikohen në marrjen e vendimeve kur kanë marrëdhënie me subjektet ose përfituesit e vendimeve. Marrëdhëniet personale nuk duhet të ndikojnë në mënyrë të papërshtatshme ose të padrejtë në marrjen e vendimeve nga anëtarët e Komitetit Sektorial.
2. Konflikti i interesave sipas rasteve të parashikuara nga Ligji nr.9367, datë 7.4.2005 "Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike", i ndryshuar, është situatë ku anëtari i Komitetit Sektorial ka një interes personal, që ndikon ose mund të ndikojë në paanshmërinë ose objektivitetin e kryerjes së detyrës.
3. Kur anëtari i Komitetit Sektorial ka dijeni se, një situatë e tillë ekziston, ai është i detyruar:
  - a) të verifikojë nëse ka një konflikt aktual të mundshëm interesash,
  - b) të ndërmarrë hapat e nevojshëm për të shmangur një konflikt të tillë,
  - c) të informojë Kryetarin e Komitetit Sektorial për konfliktin aktual ose të mundshëm të interesave,
  - d) t'i bindet çdo vendimi për të mos marrë pjesë në procesin e vendimmarrjes ose të heq dorë nga përparësitë që shkakton konflikti.

#### **Neni 5**

##### **Organizimi dhe përbërja e Komitetit Sektorial**

1. Komiteti Sektorial është organ kolegjal bashkëpunimit sistematik, që mbështet politikat e AFP-së për të lidhur Arsimin dhe Formimin Profesional me nevojat e tregut të punës dhe për të nxitur zhvillimin e aftësive në sektorin përkatës.
2. Komiteti Sektorial organizohet në formën e grupit teknik për sektorin përkatës, për të kontribuar në identifikimin e kualifikimeve profesionale të reja dhe përditësimin e kualifikimeve profesionale ekzistuese sipas nevojave të sektorit.
3. Komiteti Sektorial ka në përbërje jo më shumë se 10 anëtarë, të cilët kanë përvojë në zhvillimin dhe zbatimin e KSHK-së, si dhe njohin dinamikat dhe nevojat e sektorit si përfaqësues të sektorit publik, privat dhe ekspertë të pavarur.
4. Komiteti Sektorial ka një kryetar që zgjidhet në mbledhjen e parë dhe duhet të jetë anëtari me më shumë eksperiencë në çështjet që trajton ky komitet dhe në zhvillimin e zbatimin e KSHK-së.

#### **Neni 6**

##### **Funksionet e Komitetit Sektorial**

#### Komiteti Sektorial:

1. Identifikon në mënyrë të vazhdueshme nevojat sektoriale për kualifikime dhe bashkëpunon me institucionet zbatuese përkatëse të KSHK-së për mirëmbajtjen e Katalogut Kombëtar të Kualifikimeve për Arsimin dhe Formimin Profesional.
2. Mbështet Agjencinë Kombëtare të Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve për hartimin e standardeve të profesioneve dhe standardeve të kualifikimeve profesionale të përfshira në Katalogun Kombëtar të Kualifikimeve Profesionale, aprovon standardet e sipërcituara dhe ia përcjell për miratim ministrisë përgjegjëse për AFP.
3. Identifikon nevojat e reja dhe ndryshimet në kërkesat për aftësi profesionale në kompanitë e sektorit përkatës.
4. Identifikon qasjet më të përshtatshme për aftësimin e burimeve njerëzore bazuar në të nxënit e mëparshëm dhe parimin e të nxënit gjatë gjithë jetës.
5. Inkurajon kompanitë që ushtrojnë veprimtarinë në sektorin përkatës për përfshirjen e nxënësve dhe kursantëve në praktikat profesionale.
6. Merr vendime në lidhje me organizimin e brendshëm dhe çështjet për të cilat kërkohet vendimmartja, në kuadër të objektivave të veprimtarisë.
7. Bën propozime dhe jep rekomandime për çështje që lidhen me objektivat e veprimtarisë së tij.

#### Neni 7

##### **Mandati i anëtarëve**

1. Anëtarët e Komitetit Sektorial zgjidhen për një periudhë 4 (katër) vjeçare, me të drejtë rizgjedhjeje.
2. Në rast zëvendësimi, anëtari zëvendësues vazhdon mandatin e paraardhësit.

#### Neni 8

##### **Mbledhjet e Komitetit Sektorial**

1. Komiteti Sektorial mbledhet rregullisht, sa herë është e nevojshme jo më shumë se 1 (një) herë në 3 (tre) muaj.
2. Mbledhjet përgatiten dhe organizohen që shqyrtimi i çështjeve të planifikuara në rendin e ditës dhe vendimet e lidhura me ato, të realizohen në mënyrë efektive dhe brenda afateve të parashikuara në planin vjetor të miratuar.
3. Mbledhjet thirren nga kryetari, i cili njofton Sekretariatit Teknik për kryerjen e procedurave të njoftimit të anëtarëve për vendin, orën dhe rendin e ditës së mbledhjes vijuese.

4. Në raste të veçanta, gjatë periudhës së gjendjes së epidemive, të përcaktuara si të tilla sipas legjislacionit në fuqi dhe me dakordësinë e anëtarëve, mbledhjet mund të zhvillohen edhe Marrja e vendimeve realizohet nëpërmjet vendimit qarkullues dhe, nënshkrimi përkatës bëhet në mbledhjen vijuese kur anëtarët të jenë të pranishëm.
5. Kryetari i Komitetit Sektorial është i detyruar të thërrasë një mbledhje jashtë planifikimit të zakonshëm, kur kjo kërkohet me shkrim, nga të paktën 1/3 (një e treta) e anëtarëve me të drejtë vote, duke përcaktuar çështjet për të cilat thirret mbledhja.
6. Mbledhjet janë të vlefshme kur marrin pjesë shumica e anëtarëve. Kur nuk janë të pranishëm shumica e anëtarëve, kryetari cakton një datë tjetër për mbledhje, e cila duhet të zhvillohet të paktën 3 ditë pas datës së mbledhjes së shtyrë.
7. Vendimet merren për çështje të cilat janë përcaktuar në rendin e ditës të miratuara paraprakisht nga anëtarët, përveç rasteve kur të paktën 2/3 e anëtarëve vendosin për shqyrtimin e çështjeve që nuk janë përfshirë në rendin e ditës. Rendi i ditës miratohet në fund të çdo takimi për mbledhjen vijuese.
8. Vendimet merren me votim të hapur, me shumicën e votave të anëtarëve të pranishëm. Kur rezultati i votimit është i barabartë, vota e kryetarit është vendimtare.
9. Në çdo mbledhje mbahet një procesverbal, ku bëhet një përmbledhje e diskutimeve të mbledhjes, data dhe vendi i mbledhjes, anëtarët që morën pjesë, çështjet që u diskutuan, vendimet që u morën, si dhe forma dhe rezultati i votimit. Procesverbali mbahet nga sekretariati teknik dhe duhet t'u paraqitet për miratim të gjithë anëtarëve në fillim të mbledhjes pasardhëse. Pas miratimit procesverbali nënshkruhet së bashku nga kryetari dhe sekretariati teknik.
10. Në mbledhjet e Komitetit Sektorial mund të ftohet Drejtori i Përgjithshëm i AKAFPK-së ose profesionistë të ndryshëm, sipas nevojës. Pjesëmarrja e të ftuarve miratohet si pjesë e rendit të ditës të mbledhjes përkatëse.

### **Neni 9 Drejtimi i veprimtarisë së Komitetit Sektorial**

1. Veprimtaria e Komitetit Sektorial drejtohet nga kryetari i cili thërret dhe drejton mbledhjet, moderon diskutimet gjatë mbledhjes dhe siguron zbatimin e legjislacionit dhe të kësaj rregulloreje.
2. Nëse kryetari nuk mund të ushtrojë detyrat e tij për një periudhë të caktuar, ato kryhen nga një anëtar i komitetit deri në kthimin ose zëvendësimin e kryetarit.
3. Në rast se në një mbledhje mungon kryetari, detyrat e kryetarit ushtrohen nga një antar i komitetit.

### **Neni 10**

### **Zëvendësimi i anëtarëve të Komitetit Sektorial**

1. Anëtari i Komitetit Sektorial për shkak të largimit nga institucioni apo organizata të cilën përfaqëson ose për çdo arsye që e bën të pamundur pjesëmarrjen nuk mund të jetë më anëtar. Zëvendësimi i tij/saj bëhet duke ndjekur të njëjtat kritere dhe mënyrë përzgjedhjeje të anëtarit që do të zëvendësohet.
2. Në rast të largimit të kryetarit, vendin e tij e zë anëtari më i vjetër në detyrë deri në përfundim të mandatit.
3. Përbën shkak për largimin e anëtarit të Komitetit Sektorial:
  - a) kur largohet nga institucioni/organizata që përfaqëson;
  - b) kur mungon pa arsye në 2 (dy) mbledhje brenda një viti kalendarik;
  - c) kur jep dorëheqjen;
  - d) kur është në kushtet e pamundësisë për të kryer detyrën;
  - e) në rast se shkel rregullat e etikës;
  - f) kur dënohet me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale;
  - g) kur ndërron jetë.

### **Neni 11 Shpërblimi**

Anëtarët e Komitetit Sektorial shpërblehen për pjesëmarrjet në mbledhje sipas përcaktimeve në kuadrin ligjor për shpërblimin e anëtarëve të bordeve, në fuqi, në kohën e realizimit të mbledhjes.

### **Neni 12 Miratimi dhe hyrja në fuqi**

Kjo rregullore miratohet me urdhër të përbashkët të ministrit të Arsimit dhe Sportit dhe ministrit të Financave dhe Ekonomisë dhe hyn në fuqi menjëherë.